

Shperndarja e klimes ne toke

- **Klima** (nga greq: *pjerrtësi, klima*) është tërësia e kushteve meteorologjike mesatare dhe dukurive atmosferike gjatë një periudhe kohe të caktuar (javë, muaj, vite, dekada, njëqind ose njemijëvjeçare) në një zonë të caktuar .
- Klima karakterizohet nga një regjim shumë vjeçar i motit me të cilin nënkuptohen jo vetëm kushtet mbisunduese po edhe ata të mundshmet e motit për një vend të dhënë ose më mirë me thënë në përgjithësi klima përcaktohet si rezultat i të gjithë dukurive meteorologjike që karakterizojnë gjendjen mesatare të atmosferës me një pikë të caktuar të rruzullit tokësor. Klima paraqet një renditje të ligjshme të proceseve atmosferike që krijohen në një vend të dhënë, si rezultat i bashkëveprimit kompleks të rrezatimit diellor, qarkullimit diellor, qarkullimit të atmosferës dhe sipërfaqes aktive shtresore, bashkëveprim i cili përcakton regjimin karakteristik të motit për një vend.
- Definicionin më të shkurt, thejshtë dhe më qartë e jep autori kroat Tomisla Šegota: Moti është gjendja momentale e atmosferës, ndërsa **klima** është gjendja mesatare e atmosferës (në një hapsirë dhe kohë të caktuar).

Kima polare

Arktiku është një rajon polar i cili gjendet në pjesën më veriore të Botës. Arktiku përbëhet nga Oqeani i Ngrirë i Veriut dhe nga disa pjesë të Alaskës (SHBA), Kanadasë, Finlandës, Grenlandës, Islandës, Norvegjisë, Rosisë dhe Suedisë. Rajoni Arktik përbëhet nga një shtresë akullnajore sezonale e ndryshueshme, e rrethuar nga një tokë e ngrirë. Zona mund të përcaktohet si veriu i Rrethit Arktik (66° 33'V), i përafërt me cakun e diellit të mesnatës dhe natës polare. Ndryshe, mund të përcaktohet si një rajon ku temperaturat mesatare të muajit më të nxehtë (korrik) janë nën 10 °C. Socialisht dhe politikisht, rajoni Arktik përfshin territoret veriore të tetë shteteve arktike, megjithëse nga përkufizimet e shkencës natyrore, pjesa më e madhe e këtij territori konsiderohet si territor polar. Rajoni Arktik është një rajon i veçantë në mes të ekosistemeve të Tokës. Për shembull, kulturat në këtë rajon dhe popujt vendas të Arktikut janë mësuar me kushtet ekstreme dhe të ftohta të këtij rajoni. Në vitet e fundit, shtrirja e sipërfaqeve akullnajore është zvogëluar. Jeta në Arktik përfshin organizma që jetojnë në akull, zooplanktone dhe filoplanktone, peshq dhe gjitarë të detit, zogj, gjitarë tokësor, bimë dhe shoqëri njerëzore. Klima e Arktikut karakterizohet me dimra të ftohtë dhe verëra të freskëta. Në formë të rreshjeve zakonisht bie borë. Sasia vjetore e rreshjeve të Arktikut është e ulët, ku në shumicën e zonave bie më pak se 50 cm (20 in) në vit. Erërat e larta zakonisht nxisin dëborën, duke formuar iluzione të rreshjeve të vazhdueshme të dëborës. Temperaturat mesatare mund të jenë -40 °C, dhe temperatura më e ulët e regjistruar është -68 °C. Klima e bregdetit të Arktikut është e zbutur nga ndikimet oqeanike, duke pasur përgjithësisht temperatura më të nxehta dhe rreshje dëbore më të mëdhaja se në zonat e brendshme më të ftohta dhe më të thata. Arktiku është prekur nga ngrohja globale, duke cuar drejt shterimit të akullnajeve të Arktikut dhe lirim të metanit. Për shkak të migrimit polard të izomerit të planetit (rreth 56 km për dekadë gjatë 30 viteve të fundit si pasojë e ngrohjes globale), rajoni Arktik aktualisht është duke u zvogëluar.

Klima tropikale

- Sa me teper te largohemi nga ekuatori, aq e vogel beht sasia e reshjeve, qe bien sipas stineve: ne vere shira, ne dimer thatesire. Per kete arsye, klima tropikale qe shtrihet ne Afrike, Ameriken Jugore e Qendrore, Azine Jugore e Juglindore dhe Australi, ndahet ne dy tipa : Tropikale e Laugesht dhe e Thate. Ne klimen tropikale, qe ndryshe quhet dhe klima e savaneve, bien mesataresisht rreth 500 mm reshje ne vit. Disa rajione te kesaj klime jane gjithashtu, nen ndikimin e musoneve.

Klima musonike

Shkaktohet nga ererat q quajtura musone,te cilat kane karakter stinor,qe ndrojne drejtim dy here ne vit.Ne vere fryjne nga deti ne kontinent dhe ne dimer nga kontinenti ne det.

Klima mesadhetare

- Klima mesadhetare është tipike për viset përreth Detit Mesdhe , por ajo mund të haset edhe në jugun e Afrikës , në pjesën qendrore të Kilit dhe në Kaliforni. Ky lloj i klimës karakterizohet me atë që shirat më shumë bien në vjeshtë dhe në dimër , ndërsa pranvera dhe vera janë më të thata. Reshjet luhaten midis 400 dhe 700mm në vit. Dimrat janë të butë , ndërsa verërat janë të nxehta. Bimësinë e zakonshme e përbëjnë shkurret dhe pyjet përherë të gjelbra. Brenda këtij lloji klimatik ekzistojnë ndryshime , të cilat bëjnë që klima në bregun verior të Mesdheut të jetë më e freskët dhe më e lagësht sesa në atë të jugut , i cili është nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Saharës. Përtej bregut , në brendësi kjo klimë merr vetitë kontinentale dhe bëhet më e ftohtë.

Klima oqeanike

- Karakteristikë themelore e klimës oqeanike është ndikimi që kanë **Erërat Perëndimore** në rajonet ku mbizotëron kjo klimë . Ndryshimet e temperaturës ditore dhe vjetore janë të vogla dhe kjo bën që dimrat të jenë të butë dhe verërat e freskëta. Mesatarja e reshjeve lëviz midis 600 deri 700mm në vit , ndonëse në pjesët ku ka vargmale kjo sasi mund të tejkalojë 2000mm . Kjo klimë mund të haset në pjesët bregdetare të Evropës Perëndimore , ku rryma e Golfit zbut ndikimet e gjerësisë , pastaj haset në Amerikën Veriore , Kil , Tasmsani dhe në Zelandën e Re.

Klima subtropikale

Dallohet për vere të nxehte dhe të pasur me reshje, dimër të ftohte dhe të thatë..Keto tipare përcaktohen nga veprimi gjatë stinës së verës së musoneve detare të pasura me shira e temperatura të larta dhe gjatë dimrit të musoneve kontinentale të pakta në reshje dhe me temperatura të ulta.Vendi tipik i kësaj klime është Azia Juglindore.

Klima kontinentale

- Klima kontinentale ndahet në : Klimë të butë kontinentale dhe Klimë të thatë kontinentale
- Klima e butë kontinentale është largimi nga deti që lëkundjet e temperaturës të jenë më të shprehura gjatë gjithë ditës dhe në mes të stinëve të vitit. Gjithashtu , edhe erërat që vijnë humbin një pjesë të lagështisë së tyre dhe shkaktojnë pak reshje , rreth 400–500 mm në vit të shpërndara në mënyrë të barabartë gjatë gjithë muajve. Verërat janë të shkurtëra dhe të nxehta dhe dimrat janë të gjatë e të ftohtë. Ky lloj i klimës haset vetëm në hemisferën veriore ngase në këto gjerësi të hemisferës jugore nuk ka masa kontinentale të mjaftueshme. Ajo haset në brendësinë e Amerikës Veriore dhe në EuroAzi. Bimësia tipike është ajo e prerieve dhe stepave me bimësi të rrallë të drurëve. Klima e thatë kontinentale e hasim në viset që i njohim si shkretëtira , karakteristike kryesore e të cilave është thatësia e skajshme , ngase shirat janë të rralla , madje ato nuk bien edhe disa vite me rradhë. Gjatë ditës temperaturat janë shumë të larta , se mungesa e bimëve e bën që toka të ngrohët dhe të ftohet shumë shpejt. Shkretëtirat mund të jenë të nxehta si ajo e Saharës ose të ftohta si ato të Azisë Qëndrore. Megjithatë , shumica e shkretëtirave kanë zona të vogla me bimë , veçanërisht në vendet ku del uji nëntokësor , tll cilat formojnë Oazat. Njëra nga shkretëtirat e nxehta është Lugina e Vdekjes në Kaliforni , SHBA , ndërsa shkretëtira më e thatë është Atakama në Kil.
- PUNOI: ANDRI CEPELE I-X-E